

Prishtinë, 30.04.2007

## Njoftimi për rishikimin e Shqyrtimit të Çmimeve

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, me anë të kësaj letre, njofton për qëllimin e vet për të hapur një rishikim të shqyrtimit të kostove të lejuara dhe të ardhurave vjetore për aktivitetet e bizneseve individuale të KEK-ut për periudhën 2007-09, në pajtueshmëri me Rregullin për Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulli për Çmim-vënien), dhe Metodologjisë së Tarifave, nxjerrë nga Bordi përkatësisht më 15/12/2005 dhe 16/11/2006.

Ky rishikim është bërë i nevojshëm duke u bazuar në kërkesën e KEK të datës 25 prill 2007 paraqitur në ZRRE (publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE- së), në të cilën kanë dalë në dritë prova të reja në lidhje me shpenzimet kapitale të KEK-ut dhe "Humbjet jo teknike" të arritshme, duke e bërë të nevojshëm ekzaminimin e mëtejshëm të çështjes, sipas pikave a) dhe d) të Nenit 30.2 të Rregullit mbi Çmim-vënien.

Çdo palë që dëshiron të paraqesë komente mbi justifikimin e rihapjes së rastit të Shqyrtimit të Çmimit, është e ftuar t'i dërgojë ato në ZRRE, përmes e-mail-it në [ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org](mailto:ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org), ose përmes faksit apo letrës, duke shënuar për Vëmendjen e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve, jo më vonë se data **4 maj 2007**.